



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 29. 10. 2020

VENDIM

Nr. 47, datë 29. 10. 2020

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË PAGESËS PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE
PËR ZGJEDHJET E UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në Rregulloren "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", shkresës së Rektorit nr. 1482 prot, datë 24. 09. 2020, në mbledhjen e datës 29. 10. 2020 Bordi i Administrimit,

VENDOSI

1. Të shpërblejë në masën 75, 000 (shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, anëtarët e Komisionit Institucional Zgjedhor për zgjedhjet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë për punën e kryer gjatë këtij procesi.
2. Të shpërblejë në masën 25, 000 (njëzet e pesë mijë) lekë, anëtarët e Komisionit të Apelit dhe anëtarët e Komisioneve Zgjedhore në Fakultete, për zgjedhjet në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë për punën e kryer gjatë këtij procesi.
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Dr. Ervis MOÇKA

